



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 13, DATË 20.02.2020

PËR

**MIRATIMIN E PAGESËS ME KËSTE TË DETYRIMEVE FINANCIARE PËR
VITIN 2020, TË SUBJEKTEVE TË AUTORIZUAR PËR PËRSËRITJEN E
SHËRBIMIT PROGRAMOR NË RRJET KABLLOR DHE IPTV, PËR TË
OFRUAR SHËRBIM NË QARKUN DURRËS**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: AMA kryesisht,

Objekt: Për miratimin e pagesës me këste të detyrimeve financiare për vitin 2020, të subjekteve të autorizuar për përsëritjen e shërbimit programor në rrjet kabllor dhe IPTV, për të ofruar shërbim në zonat e prekura nga tërmeti i muajit nëntor 2019

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 23 dhe neni 25 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) është depozituar shkresa e shoqërisë "Bleta" sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV), administruar me nr. 1791 prot., datë 30.01.2020 me lëndë "Kërkesë për pagesë me këste".

Në këtë shkresë, subjekti parashtron një sërë problematikash lidhur me kontratat me abonentët, banorë të qytetit të Durrësit, si më poshtë:

“Për arsye të fatkeqësisë natyrore (tërmetit), të ndodhur në 26 nëntor 2019 dhe pasojave që la pas, shumica e klientëve tonë janë larguar nga banesat e tyre të dëmtuara dhe kjo ka cuar drejt përfundimit të kontratës që kanë me kompaninë tonë, duke ulur kështu të ardhurat tona dhe të detyruar t’i kthejmë mbrapsht pagesat e bëra.

Duke marrë parasysh arsyen më sipër dhe duke u bazuar tek faktura e nisur për pagesën për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe në pamundësi për t’a kryer të plotë pagesën t’a bëjmë me gjashtë këste të ndara në gjashtë muaj.”

AMA, në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, ka njoftuar gjatë muajit janar 2020, të gjithë subjektet e pajisur me autorizim dhe/ose licence, për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit.

Në këto komunikime, AMA ka bërë me dije subjektet, se bazuar në pikën 4 të nenit 25 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikën 1, Kreu IV, të vendimit të AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017, duhet që: *“pagesa vjetore të kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet kamatëvonesë në masën 0.1% të vlerës së detyrimit të mbetur për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 30% e vlerës së pagesës vjetore. Detyrimi i lindur në formën e kamatëvonesës së vitit paraardhës dhe i palikuiduar brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, përfshihet në pagesën vjetore për licencë/autorizim të vitit pasardhës”.*

Lidhur me kërkesën për shlyerjen e detyrimeve financiare, pagesë vjetore për autorizim, përmes pagesës me këste, për një periudhë 6 mujore, AMA konstaton se ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk parashikon shprehimisht shlyerjen e detyrimeve vjetore, pagesë vjetore për autorizim, përmes pagesës me këste. Pika 4 e nenit 25 të ligjit nr. 97/2013, të sipërcituar parashikon se: *“... Pagesat vjetore kryhen brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik”.* Kjo dispozitë përcakton afatin përfundimtar të shlyerjes së pagesës vjetore për licencë dhe tarifës për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive brenda datës 31 mars të çdo viti kalendarik për të cilin ushtrohen të drejtat e licencës/autorizimit.

Bëjmë me dije se pavarësisht se në ligjin tonë organik nuk gjen rregullim çështja e shlyerjes së detyrimeve me këste, referuar legjislacionit tatimor në fuqi në RSH, parashikohet që subjekti tatimpagues në rastet kur janë në pamundësi financiare, për të shlyer detyrimet tatimore lejohet të lidhë marrëveshje për pagesën me këste.

Mbajtur parasysh situatën e rëndë të krijuar për shkak të fatkeqësisë natyrore, tërmetit të ndodhur në datën 26 nëntor 2019, si dhe faktin që subjektet e autorizuar për të ofruar shërbim në zonat e goditura më së shumti, AMA arrin në përfundimin se subjekteve që janë të pajisur me autorizim për të ofruar shërbim audioviziv në këto zona, t’u jepet mundësi të shlyejnë detyrimin financiar ndaj autoritetit përmes pagesës me këste.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë rezulton se prej këtij vendimi do të përfitojnë 6 subjekte të autorizuar nga AMA për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në

rrjet në rrjet kabllor dhe internet (IPTV), të cilët ushtrojnë aktivitetet vetëm në zonat e prekura dhe jo në territor të gjerë administrative.

Në tabelën më poshtë pasqyrohen subjektet:

	Bashkia Durrës		Subjektet e autorizuar nga AMA për ripërsëritës IPTV dhe për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor
1	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Durrës R1	"TV Kabllor KL-ED"; "Bleta IPTV"
2	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Durrës R2	
3	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Durrës R3	
4	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Durrës R4	
5	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Durrës R5	
6	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Manëz	"Tv Kabllor Manza"
7	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Sukth	"TV Kabllor J&P PRO"
8	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Ishem	
9	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Katund I ri	
10	Bashkia Durrës	Njesia Administrative Rashbull	
Bashkia Krujë			
1	Bashkia Krujë	Njesia Administrative Kruje	
2	Bashkia Krujë	Njesia Administrative Fushe Kruje	
3	Bashkia Krujë	Njesia Administrative Bubq	
4	Bashkia Krujë	Njesia Administrative Cudhi	
5	Bashkia Krujë	Njesia Administrative Kodër Thumanë	"Tv Kabllor Tërbuf"
6	Bashkia Krujë	Njesia Administrative Nikel	
Bashkia Shijak			
1	Bashkia Shijak	Njesia Administrative Shijak	"TV Kabllor Shijaku".
2	Bashkia Shijak	Njesia Administrative Gjepalaj	
3	Bashkia Shijak	Njesia Administrative Maminas	
4	Bashkia Shijak	Njesia Administrative Xhafzotaj	

Në këto kushte, AMA vlerëson se për t'u ardhur në ndihmë subjekteve të mësipërme, është i nevojshëm miratimi i vendimit për shlyerjen e detyrimeve financiare të njoftuara subjekteve të mësipërme për vitin 2020, përmes pagesave deri në 4 (katër) këste, deri më datë 21 dhjetor 2020, pa aplikuar kamatëvonesë.

Sa më sipër, pagesat duhet të kryhen: kësti i I-rë deri më 31 mars 2020, kësti i II-të deri më 30 qershor 2020, kësti i III-të deri më 30 shtator 2020 dhe kësti i IV-ët deri më 21 dhjetor 2020.

Në rast të mosshlyerjes të kësteve brenda afateve të mësipërme, do të aplikohet kamatëvonesë për çdo ditë vonesë të kryerjes së pagesës të këstit përkatës.

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Shlyerjen e detyrimeve financiare të njoftuara për vitin 2020, përmes pagesës me këste, prej subjekteve të autorizuara nga AMA për përsëritjen e shërbimit në rrjet IPTV dhe për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor, të cilët ushtrojnë aktivitet vetëm në zonat e prekura nga tërmeti, si më poshtë:
 - 1.1 "Bleta" (IPTV) për qytetin Durrës;
 - 1.2 "TV Kabllor Kl-Ed" për njësinë administrative Durrës;
 - 1.3 "Tv Kabllor Manza" për njësinë administrative Manëz;
 - 1.4 "TV Kabllor J&P PRO" për njësinë administrative Sukth;
 - 1.5 "Tv Kabllor Tërbuf" për njësinë administrative Kodër Thumanë;
 - 1.6 "TV Kabllor Shijaku" për njësinë administrative Shijak.
2. Detyrimi financiar i subjekteve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, do të shlyhet i ndarë përmes pagesave deri në 4 (katër) këste, deri më datë 21 dhjetor 2020, pa aplikuar kamatëvonesë. Pagesat do të kryhen sipas grafikut të mëposhtëm:
 - kësti i I-rë deri më 31 mars 2020;
 - kësti i II-të deri më 30 qershor 2020;
 - kësti i III-të deri më 30 shtator 2020;
 - kësti i IV-ët deri më 21 dhjetor 2020.
3. Në rast të mosshlyerjes të kësteve brenda afateve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, do të aplikohet kamatëvonesë për çdo ditë vonesë të kryerjes së pagesës të kështit përkatës.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA